VENDIM
Nr.294, datë 16.5.2007

PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, DËRGUAR ME MISIONE USHTARAKE JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2007, të bëjë me INSIG sh.a., sigurimin e jetës dhe të aksidenteve në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë me mision ushtarak jashtë shtetit.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha